



QENDRA PËR NISMA LIGJORE QYTETARE

Regjistruar me vendimin nr.8/1, dt.14.12.2004 të Gjykatës së Rrethit Tiranë
TEL.04 2259795 FAX.04 2 241914

P.O.BOX1549 E- MAIL: avokatore@albmail.com

RAPORTI VJETOR

Për periudhën 2 vjeçare

Janar 2007-Dhjetor 2008

PËRMBAJTJA

PËRSHËNDETJE!

I. ORGANIZATA JONË

1.1 QNL dhe partnerët e saj.

1.2 Fushat e veprimtarisë.

1.3 Pikat kyçe të veprimtarisë së organizatës gjatë periudhës së raportimit.

1.4 Publikimet

1.5 Struktura Organizative e QNL-së

II. SHËRBIMET NË PERCEPTIMIN E PËRFITUESVE

2.1 Intervistë me përfituesen e shërbimeve d.m

2.2 Intervistë me anëtarin e skuadrës *probono* të fakultetit të drejtësisë pranë UFO University, Alban Duraj

III. FINANCAT DHE TRANSPARENCA E QNL-së

IV. IMPAKTI I PROJEKTEVE TË ZBATURA MBI ORGANIZATËN

V. ANEKS 1-Projektet dhe programet e zbatuara nga QNL

VI. ANEKS 2- Projektet dhe programet zbatuar nga QNL në bashkëpunim me OJF të tjera.

VII. FOTO-GALERI

PËRSHËNDETJE!



Të nderuar miq,

Kam kënaqësinë të paraqes përpara jush Raportin e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, i cili përmban një përmbledhje të punës dhe veprimtarisë sonë për periudhën dy-vjeçare, 2007-2008. Në kuadrin e komunikimit dhe transparencës, ky raport do të shërbejë për t'u njohur me të gjitha aktivitetet dhe veprimtaritë e Qendrës dhe për të shkëmbyer përvojat tona në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe rritjes së aksesit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Vitet 2007-2008 kanë shënuar zhvillime të rëndësishme për organizatën tonë, si për forcimin e saj organizativ e profesional, ashtu edhe për zbatimin e projekteve. Ka pasur një rritje të punës për mbështetjen me ndihmë ligjore të grave dhe vajzave të dhunuara/të varfra. Rreth 1780 kliente/klientë kanë marrë ndihmë ligjore falas gjatë këtyre dy vjetëve. Gjithashtu, është rritur veprimtaria e Qendrës për zbatimin e ligjeve të reja në fushën e barazisë gjinore dhe të luftës kundër dhunës në familje, që kanë hyrë në fuqi rishtazi. Është intensifikuar aktiviteti për edukimin ligjor të shtetasve, veçanërisht për banorët në zonat rurale, si dhe është forcuar bashkëpunimi ndërinstitucional me organizatat simotra jofitimprurëse dhe me institucionet shtetërore.

Organizata jonë ka besuar gjithmonë se nuk mund të kemi rezultatet që synojmë pa bashkëpunimin me partnerët tanë të shoqërisë civile dhe aktorët e qeverisjes qendrore e vendore. Për këtë arsye, kemi mëshuar në forcimin e këtij bashkëpunimi, jo vetëm përmes zbatimit të projekteve të përbashkëta, por edhe përmes konsultimeve e shkëmbimit të eksperiencave tona në këtë fushë. Një aspekt i veçantë i suksesit tonë ka qenë mbështetja dhe bashkëpunimi me donatorët tanë, të cilët i falenderoj në mënyrë të veçantë.

Në përfundim, falenderoj gjithashtu, të gjithë anëtarët e Bordit dhe të stafit të QNL-së, për gatishmërinë dhe profesionalizmin që kanë dëshmuar gjatë kësaj periudhe.

Ju faleminderit,

Aurela Anastasi
Drejtoresh Ekzekutive

I. ORGANIZATA JONË

E krijuar në vitin 1997, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare është specializuar në ndihmën ligjore për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, veçanërisht për gratë dhe vajzat, në edukimin ligjor të shtetasve, si dhe në lobimin e nismave ligjore në interes të tyre.

1.1 QNL DHE PARTNERËT E SAJ

Një pjesë e rëndësishme e suksesit, arritjeve dhe profesionalizmit të organizatës sonë i dedikohet partnerëve tanë strategjikë ndër vite. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka siguruar qëndrueshmërinë e saj nëpërmjet mbështetjes së donatorëve dhe partnerëve:

Falenderim i veçantë për partnerët dhe donatorët tanë!

Swedish Helsinki Committee
for Human Rights

Komiteti Suedez i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut



Ambasada Amerikane në Tiranë

Zyra e Marrëdhënieve me Publikun e Ambasadës së SH.B.A-së në Tiranë



Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Soros



Global Fund for Women




USAID

2. FUSHAT E VEPRIMTARISE


QNL kontribuon për zhvillimin e komunitetit, në mënyrë të veçantë të grave dhe vajzave të dhunuara dhe/ose të varfra. Aktivitetet tona konsistojnë:

- ◆ Ndihmë ligjore dhe psikosociale, për grupet në nevojë, në veçanti për grate e dhunuara nga dhuna e ushtruar në marrëdhëniet familjare ose jashtë saj, për gratë e trafikuar si dhe për gratë e varfra, përmes këshillimeve dhe ndjekjes së çështjeve administrativisht ose gjyqësisht.
- ◆ Ndërmarrja e përfshirja me nisma ligjore dhe në procese lobimi, që synojnë të sigurojnë miratimin dhe zbatimin e ligjeve dhe akteve të tjera normative.
- ◆ Edukimi ligjor me qëllim ndërgjegjësimin publik të qytetarëve, lidhur me gëzimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.
- ◆ Studime dhe monitorime mbi projekt-ligjet, legjislacionin dhe zbatimin e tij.
- ◆ Trajnime të profesionistëve të sistemit të drejtësisë dhe profesionistëve të tjerë.
- ◆ Përfshirja e të rinjve në aktivitetin e Qendrës, përmes krijimit të skuadrave *pro bono*, trajnimit të anëtarëve dhe përkujdesjes së tyre përmes avokatëve të Qendrës.

3. PIKAT KYÇE TË VEPRIMTARISË SË ORGANIZATËS GJATË PERIUDHËS SË RAPORTIMIT Viti 2007




Viti 2008



4. PUBLIKIMET

Studimet dhe botimet profesionale përbëjnë një nga pikat e forta të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare. Ato përbëjnë në vetvehte jo vetëm rezultate të punës sonë, por edhe një mjet lobimi për organizatën tonë dhe organizatat e tjera jofitimprurëse që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut, në mënyrë të veçantë për rritjen e aksesit të grave dhe vajzave të varfëra dhe/ose të dhunuara në sistemin e drejtësisë dhe shërbime të tjera.



Revista profesionale ligjore, “Ligji-Mundësi zhvillimi për gratë”, nr.1(18), mars 2008

Kjo revistë i është dedikuar në mënyrë të veçantë çështjeve të ligjit e të drejtësisë lidhur ngushtë me problemet e trafikimit të qenieve njerëzore, dhunës në familje si dhe aspekteve të tjera të barazisë gjinore. Kjo revistë ofron mundësinë që punonjësit e organeve të drejtësisë të njihen me legjislacionin evropian dhe me praktikën gjyqësore të gjykatave ndërkombëtare të vendeve demokratike më të përparuara, në lidhje me këto çështje.



“Organet e drejtësisë në luftën kundër korrupsionit”

Raporti u hartua nga ekspertët: Prof.As.Vasilika Hysi, Prof.Dr.Av. Aurela Anastasi, Dr.Altin Shegani, Jola Xhafo (master).

Ky raport është rezultat i një pune monitoruese dhe është përgatitur në kuadrin e zbatimit të projektit “Rritja e aksesit dhe besimit të shtetasve në organet e drejtësisë përmes zbatimit me efektivitet të legjislacionit shqiptar, si mjeti më i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit”. Monitorimi evidentoi praktikën e ndjekur nga Prokuroria dhe Gjykatat e rrethave Tiranë, Shkodër e Vlorë në gjykimin dhe goditjen e veprave penale që lidhen me korrupsionin gjatë viteve 2004-2006.

Konkluzionet e dala nga monitorimi në praktikën hetimore dhe atë gjyqësore kanë ndihmuar në përmirësimin e praktikave të organeve të drejtësisë si dhe të organeve që i kontrollojnë ato. Raporti përfshin konkluzione të rëndësishme që kanë dalë nga monitorimi në aspektin gjinor, gjë që ka sjellë një vizion të ri të analizës në këtë këndvështrim.



“Transparenca-një rrugë drejt besimit të publikut”

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit “Transparenca-një rrugë drejt besimit të publikut”, zbatuar nga “Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim”, “Skuadra 2000” dhe “Qendra për Nisma Ligjore Qytetare”, me mbështetjen e OSFA-Fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë”.

Në këtë botim janë përfshirë disa studime të përgatitura nga ekspertë të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare si: “Roli i Organizatave për forcimin e rendit kushtetues në Shqipëri, Kushtetuta dhe Organizatat Jofitimprurëse”, “Transparenca

e OJF-ve nëpërmjet krijimit dhe regjistrimit të tyre sipas ligjit”, “Paketa fiskale dhe OJF-të”; “Analizë e nivelit të transparencës së shoqërisë civile në Shqipëri”.

Studimet synojnë të promovojnë mekanizmat për rritjen e transparencës së Organizatave Jofitimprurëse në Shqipëri.



Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe roli tij në luftën kundër këtij fenomeni¹

nga Prof. Dr. Aurela Anastasi; Av. Aurela Bozo

1. Disa refleksione mbi rezultatet e monitorimit të vendimeve gjyqësore për lëshimin e urdhërave civilë të mbrojtjes nga gjykatat e rretheve gjyqësore tiranë dhe vlorë

1. Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (nr. 9669, datë 18.12.2006), shënoi një nga hapat më të sigurt për përafrimin e legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare në fushën e legjislacionit kundër dhunës në familje. Por, çështja e zbatimit të tij, është e domosdoshme pasi me mjetet ligjore që ofron, ai mund të shndërrohet në një faktor të rëndësishëm për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje.

Ligji hyri në fuqi më 1 qershor të vitit 2007 dhe për periudhën 11 muajore gjatë së cilës kemi kryer këtë monitorim (1 qershor 2007- 30 prill 2008), janë identifikuar vetëm 20 vendime gjyqësore për lëshimin e urdhërave civilë të mbrojtjes nga dy gjykata: Tiranë e Vlorë. Aktualisht, gjendja ka ndryshuar mjaft. Në gjashtë muajt e fundit, zbatimi i ligjit është shtrirë jo vetëm në Tiranë e Vlorë, por edhe në pjesën më të madhe të rretheve gjyqësore të vendit. Rezulton se ka një rritje të ndërgjegjësimit të grave dhe vajzave për denoncimin e dhunës në familje. Kjo duket qartë kur shohim se numri i rasteve të trajtuara nga Gjykata e Shkallës

¹ Mbështetur në raportin monitorues përgatitur nga studentët e skuadrës pro bono të Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit UFO nën mbikëqirjen e ekspertëve të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare

-101-

Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe roli i tij në luftën kundër këtij fenomeni

Studim

Ky studim është botuar në revistën Gaia, botim i Qendrës “Aleanca Gjnore për zhvillim” dhe është fokusuar në arritjet dhe sfidat në lidhje me zbatimin e Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Gjetjet dhe rekomandimet e përfshira në të janë mbështetur në monitorimin e vendimeve për lëshimin e urdhërave mbrojtës/urdhërave të menjëhershëm të mbrojtjes të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Vlorë për periudhën 1 Qershor 2007- 30 Prill, 2008.

Studimi u është bërë i njohur organizatave jofitimprurëse që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të drejtave të grave në mënyrë të veçantë si edhe institucioneve shtetërore dhe donatorëve.



Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, ligj për mbrojtjen e familjes dhe të drejtave themelore të njeriut

Kjo fletëpalosje synon të rrisë nivelin e njohurive të komunitetit për mjetet ligjore që ofron ligji nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Fletëpalosja i është shpërndarë komunitetit, klienteve të qendrës, gra dhe vajza të dhunuara, organizatave të ndryshme jofitimprurëse që punojnë me shtresat në nevojë.

”Njihuni me të drejtat tuaja dhe gëzojini ato”

Kjo fletëpalosje synon të ndërgjegjësojë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore ose grupet në rrezik për tu trafikuar se legjislacioni ynë ka parashikuar të drejta për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtje për grupet në rrezik për tu trafikuar.

Fletëpalosje informon mbi shërbimet që ofron Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në mbrojtje të viktimave të trafikimit dhe dhunës.



5. Struktura Organizative e QNL-së


Bordi i QNL-së

Bordi Drejtues është organi më i lartë vendimmarrës në Qendër.

Pas rinovimit të kryer në vitin 2007, Anëtarë të Bordit janë:

1. Flutura Guri, avokate, Kryetare e Bordit Drejtues;
2. Rezar Xhelo, anëtar i Bordit Drejtues;
3. Vjollca Mecaj, anëtare e Bordit Drejtues;
4. Teuta Rino, anëtare e Bordit Drejtues;
5. Virgjil Karaj, anëtar i Bordit Drejtues;
6. Petraq Pojani, anëtar i Bordit Drejtues;
7. Eralda Methasani, anëtare e Bordit Drejtues;

Struktura Organizative e QNL-së



Stafi i QNL-së punon me pasion dhe përkushtim për të rritur aksesin e komunitetit në sistemin e drejtësisë, në mënyrë të vecantë grave dhe vajzave që përballen me dhunën me bazë gjinore. Në pjesën më të madhe të tij stafi përbëhet avokatë të specializuar kryesisht në fushat: e drejta kushtetuese; e drejta familjare, e drejta e punës, si dhe në zbatimin e legjislacionit kundër dhunës në familje e të barazisë gjinore.

Një pjesë e stafit të qendrës sonë angazhohet edhe në mësimdhënie në universitete publike dhe private.

Përveç bashkëpunimit me organizata të tjera të rrjetit, Qendra ka edhe një grup bashkëpunëtorësh, ekspertë me përvojë. Gjithashtu, pranë Qendrës janë angazhuar edhe

80 studentë të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Universitetit të Vlorës dhe UFO University, anëtarë të katër skuadrave *probono* të krijuara pranë QNL-së, gjatë 2 viteve të fundit. Nën mbikëqyrjen e avokatëve të qendrës, studentët kanë ofruar kontributin e tyre në ofrimin e këshillimeve ligjore, përgatitjes së akteve për në gjykatë ose institucione të ndryshme; edukim ligjor të komunitetit, si dhe në rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit për të përdorur mjetet ligjore nëpërmjet medias elektronike dhe të shkruar.

II. SHËRBIMET NË PERCEPTIMIN E PËRFITUESVE.

2.1 Intervistë me klienten D.M

”Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë mësova për shërbimet ligjore falas që ofron Qendra për Nisma Ligjore Qytetare. U drejtova pranë kësaj qendre dhe menjëherë mu ofrua mbështetje psiko-sociale, dhe avokatja e qendrës më këshilloi dhe përgatiti kërkesën për urdher mbrojtje. Avokatja e qendrës më përfaqësoi në gjyq dhe gjykata lëshoi menjëherë urdhrin e mbrojtjes. Kuptova që nuk jam vetëm dhe që çështja e dhunës në familje përbën një çështje shqetësuese jo vetëm për mua por për gjithë shoqërinë”.

2.2 Intervistë me anëtarin e skuadrës pro bono, Alban Duraj

”Eksperienca ime pranë Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare ka qene shumë e vlefshme për mua. Ishte eksperienca e parë pranë një qendre që ofron shërbime ligjore falas për grupet në nevojë, e cila më shërbeu për materializimin e dijeve teorike. Pasi jam trajnuar nga qendra mbi zbatimin e ligjit ”Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” jam përfshirë në aktivitete të ndryshme si: këshillim ligjor dhe përgatitje aktesh (kryesisht kërkesa për urdhra mbrojtje dhe zgjidhje martese drejtuar gjykatës) për gratë dhe vajzat e dhunuara; rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit përmes medias së shkruar dhe elektronike; përfshirja në ëorkshopet që qendra ka organizuar me komunitetin në zonat rurale. Ishte një mundësi shumë e mirë për të filluar rrugën e gjatë të profesionistit”.

III. FINANCAT DHE TRANSPARENCA E QNL-së

Authorized Accounting Expert

HETEM SULAJ
Professional license IEKA
N0.017, DATE 10.02.2000.

Independent Audit Report

Addressed to: Center for Legal Civic Initiatives

Address: Rr."Vaso Pasha", Pall.12,Shk.1,Ap.1,Tirana, Albania
NIPT: K11506001U

In execution of the mission, we have audited the financial tables of the Center for Legal Civic Initiatives, Non Profitable Organizations which includes the financial tables on December 31, 2008.

Responsibilities of the management on implementation of the project

Management is responsible on preparation and sincere submission of the financial tables in compliance to Albanian Standards of Financial Reporting.

This responsibility includes: compiling, implementation and performance of the proper internal control on preparation and sincere submission of the financial tables that results without material anomalies, either due to fraud or fault reasons, on choice and implementation of the suitable accounting principles and to achieve reasonable accounting evaluations in regard to the financial circumstances.

The responsibilities of the Independent Auditor

Our responsibility is to express an opinion on these financial tables based on our audit. We have performed the audit in compliance to International Standards of the Audit. These standards require by us to implement the ethic requirements as well as planning and performing our audit procedures in order to gain reasonable guaranties if the financial tables are without material anomalies.

The audit includes the performance of procedures in order to obtain auditing evidence about sums and information given on the financial tables. The chosen procedures depend on the auditor's judgment, including the evaluation of risks for material anomalies on the financial tables, either due to fraud or fault reasons.

Evaluating such risk, the auditor takes into consideration the relevant internal control of the entity on sincere preparation and submission of the financial tables in order to draft the proper procedures of auditing which are suitable for circumstances, but not aiming to express his opinion on the efficiency of the internal control of the entity.

Also audit includes the evaluation of the suitability of the accounting methods used, the logic of account evaluations done by the management, and evaluation of the general presentation of the financial tables.

We believe that the evidences we have received are sufficient and suitable to form the basis of our audit opinion.

According to our opinion, the financial tables reveals a true and sincere image of the financial situation of the Center for Legal Civic Initiatives on December 31, 2008 about the financial results of activity exercised and closed up to that data and are in compliance to Albanian Standards of the Financial Reporting.

Tiranë, on March 20, 2009.

Auditor
HETEM SULAJ



IV. IMPAKTI I PROJEKTEVE TË ZBATURA MBI ORGANIZATËN

Në përgjithësi projektet e zbatuata gjatë vitit 2007 dhe 2008 kanë forcuar kapacitetet e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare në këto drejtime:

-  **a. Strategji dhe politika/ planifikimi afatgjatë** është zhvilluar brenda organizatës. Organizimi i aktiviteteve të ndryshme në kuadrin e projekteve të sipërpërmendura, përgatitja e instrumenteve matës dhe përdorimi i pyetsorëve e formave të vlerësimit ka pasur impakt në aktivitetin e organizatës duke përcaktuar qartë fushat e ndërhyrjes në të ardhmen
-  **b. Kapacitetet dhe motivimin e stafit të QNL-së.** Janë forcuar kapacitetet e stafit të QNL-së për të përdorur të drejtat ligjore dhe standartet ndërkombëtare si mjet për të bërë realitet të drejtat e viktimave të dhunës me bazë gjinore.
-  **c. Sistemet/** Në sajë të zbatimit të programeve të përmendura proceset e brendshme që rregullojnë funksionimin e organizatës janë zhvilluar, në mënyrë të veçantë raportimi, monitorimi, vlerësimi dhe procesi i të mësuarit.
-  **f. Rrjetet /** Është forcuar Roli aktiv i QNL-së brenda rrjeteve të ndryshme, në mënyrë të veçantë Rrjetit kundër trafikimit dhe Dhunës me bazë gjinore.

V. ANEX 1- Projektet dhe programet zbatuar nga QNL

Lista e projekteve dhe Programeve 2007-2008

1. “Forcimi i grave në nevojë përmes rritjes së nivelit të tyre të informacionit mbi të drejtat ligjore, ofrimit të asistencës ligjore falas në ushtrimin e të drejtave, lobimit për ndryshime ligjore dhe inkurajimit të praktikave gjyqësore në favor të ushtrimit të të drejtave njerëzore të grave”, mbështetur nga **Komiteti Suedez i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut**, Periudha e zbatimit të projektit Qershor 2008-Shkurt 2009. Shuma e buxhetit 24 980 EUR.
2. “Edukimi ligjor dhe Mbrojtja e të Drejtave. Aksesit në drejtësi i personave të trafikuar dhe grupeve në nevojë”, mbështetur nga **OSBE/ODIHR**. Shuma e buxhetit për vitin 2007, 2008 është 40131 Eur. Periudha e zbatimit të projektit 30 Prill 2007- 30 Prill 2008-Dhjetor 09.
3. “Rritja e aksesit në drejtësi për gratë dhe vajzat përmes ndihmës ligjore falas”, mbështetur nga **World Learning/FORECAST**. Periudha e zbatimit të projektit 16 Nëntor 2007-30 Maj 2008. Shuma 9516 usd.
4. “Rritja e aksesit të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në sistemin e drejtësisë për të ushtruar të drejtën për kompensim përmes forcimit të kapaciteteve të profesionistëve të sistemit të drejtësisë dhe ndryshimeve ligjore”, mbështetur nga **Ambasada Amerikane në Tiranë**. Periudha e zbatimit të projektit Shtator 08-Shtator 09. Buxheti 18 743 USD.
5. “Forcimi i grave në nevojë përmes ofrimit në vazhdimësi të shërbimeve ligjore dhe psikosociale”, mbështetur nga **Global Fund for Women**. Periudha e zbatimit të projektit Mars 2008-mars 2009. Buxheti 6990 USD.
6. Rritja e aksesit dhe besimit të qytetarëve në organet e drejtësisë përmes zbatimit efektiv të legjislacionit Shqiptar si një mjet i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit. Ky projekt është mbështetur nga **Casals and Associates Inc. /USAID**. Periudha e zbatimit 01 Dhjetor 2006-30 Maj 2007. Buxheti i projektit 23 992 Eur.
7. Rritja e nivelit të njohurive të komunitetit, në mënyrë të veçantë grave dhe vajzave në zonat rurale dhe ndërrbane mbi të drejtat e grave dhe aftësimi i tyre për ti përdorur këto të drejta. Mbështetur nga **Ambasada Amerikane në Tiranë**. Periudha e zbatimit 1 Shtator 2006-01 Shtator 2007. Buxheti i projektit 16.255 USD.

Forcimi i grave dhe vajzave në zonat rurale dhe ndërrbane përmes rritjes së nivelit të njohurive mbi të drejtat e tyre ligjore, aftësimi për ti përdorur këto të drejta dhe shërbimeve ligjore. Mbështetur nga **Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë Soros**. Periudha e zbatimit 01 Dhjetor 2006-01 Prill 2007. Buxheti i projektit 6993 USD.

Treguesit e projekteve

Emri i projektit	Koha e zbatimit	Donatori	Fondi	Zbatohet në
“Forcimi i grave në nevojë përmes rritjes së nivelit të tyre të informacionit mbi të drejtat e tyre ligjore, ofrimit të asistencës ligjore falas në ushtrimin e të drejtave, lobimit për ndryshime ligjore dhe inkurajimit të praktikave gjyqësore në favor të ushtrimit të të drejtave njerëzore të grave.”.	Qershor 2008-Shkurt 2009	Ky projekt është mbështetur nga Komiteti Suedezi i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.	24980 EUR	Tiranë

Projekti përmbushi forcimin e grave në nevojë përmes rritjes së nivelit të tyre të informacionit mbi të drejtat e tyre ligjore, ofrimit të asistencës ligjore falas në ushtrimin e këtyre të drejtave dhe lobimit për ndryshime ligjore dhe inkurajimit të praktikave gjyqësore në favor të ushtrimit të të drejtave njerëzore të grave.

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E PERFORMANCES	
Objektivi 1: Të rritet numri i grave dhe vajzave të varfëra dhe/ose të dhunuara që përfitojnë nga shërbimet e ofruara nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, mbështetja psiko sociale dhe asistencë ligjore falas.	
Treguesit të arritjes	Në lidhje me përmbushjen e këtij objektivi, avokatet e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare kanë mbështetur me asistencë ligjore falas 207 kliente. 138 prej tyre ose 66.7% kanë përfituar mbështetje ligjore dhe psiko sociale falas dhe 69 kliente ose 33.3% janë mbështetur përmes ndjekjes së çështjeve gjyqësore. Në lidhje me ndihmën ligjore falas janë ofruar 256 këshillime ligjore; Janë përgatitur 75 akte ligjore dhe janë ndjekur 64 sesione gjyqësore.
Objektivi 2. Të kontribuojë në zbatimin e ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.	
Tregues të arritjeve	Nga 69 kliente me dosje në gjykatë, janë mbështetur 21 kliente ose 30.4 % me urdhra mbrojtje ose urdhra të menjëhershëm mbrojtje, mjete ligjore të ofruara nga ligji nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.
Objektivi 3: Të ofrohet asistencë ligjore e vazhdueshme për çështje familjare, në	

zbatim të Kodit të Familjes.	
Treguesit e arritjes	Janë mbështetur 25 gra, 36.2% e klienteve me dosje për çështje me objekt zgjidhjen e martesës. Gjithashtu janë mbështetur me asistencë ligjore falas kliente për çështje me objekt kujdestarinë e fëmijëve, caktimin e pensionit ushqimor etj.
Objektivi 4: Të forcohet bashkëpunimi me organizatat e tjera Jofitimprurëse që punojnë për adresimin e dhunës me bazë gjinore.	
Treguesit e arritjes	QNL ka forcuar bashkëpunimin me anëtarët e rrjetit kundër dhunës me bazë gjinore dhe trafikimit si Strehëza për Gra dhe Vajza të dhunuara; Shoqata Refleksione; Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza të Dhunuara; Aleanca Gjinore për Zhvillim; Qendra për Zhvillimin e Grave Rurale; Të ndryshëm dhe të barabartë; etj. Mënyrat e forcimit të bashkëpunimit me Organizatat Jofitimprurëse kanë qenë: • Sistemi i referimit të rasteve të grave dhe vajzave të dhunuara nga një Organizatë Jofitimprurëse tek tjetra, për të përfutur nga shërbimet e ofruara nga secila prej këtyre organizatave. • Duke qenë së bashku me të gjithë anëtarët e Rrjetit kundër Dhunës me bazë gjinore dhe trafikimit në aktivitetet e organizuara në 16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore. • Ofrimi i ekspertizës në çështje të dhunës në familje ose forma të tjera të dhunës kundër grave dhe vajzave për rastet e paraqitura anëtarëve të Rrjetit kundër dhunës me bazë gjinore dhe trafikimit dhe Organizatave të tjera Jofitimprurëse. • Pjesëmarrja aktive në aktivitetet e çdo organizate, anëtare e Rrjetit kundër dhunës me bazë gjinore dhe trafikimit me fokus në adresimin e dhunës me bazë gjinore.
Objektivi nr.5: Të rrisë ndjeshmërinë dhe nivelin e njohurive të komunitetit, në mënyrë të veçantë grave dhe vajzave mbi të drejtat ligjore.	
Treguesit e arritjes	• 4 workshope janë organizuar me gratë dhe vajzat në zonat rurale dhe ndërrbane në Bathore, Sauk, Kashar-Preze, Babrru, me synim rritjen e nivelit të njohurive mbi të drejtat dhe mjetet ligjore të ofruara në ligjin “Për masat

	ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, ligjin për barazinë gjinore në shoqëri, Kodin e Punës, legjislacionin civil, Kodin e Familjes etj. Numri i përfituesëve të drejtpërdrejtë ishte 120. • Janë përgatitur dy fletëpalosje mbi aktivitetin e QNL-së, shërbimet e ofruara dhe përmbajtjen e ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. • Stafi i QNL-së ka marrë pjesë në emisione televizive me qëllim informimin e komunitetit për mjetet ligjore në Televizionin Publik Shqiptar, Televizionin Vizion Plus, Televizionin Top Channel, etj. • Janë përgatitur dhe botuar 4 artikuj në revistat: “Psikologji”; “Gaia”; “Transparenca një rrugë drejt besimit të publikut”; revistës shkencore të Universitetit “Justicia”; dhe në gazetatat: “Panorama”; “Zemra e Krishtit dhe unaza e tij”; “Buletini i Rjetit kundër Dhunës me bazë gjinore dhe Trafikimit”; “Dhuna në familje në fokusin e medias”.
--	--

II.

Emri i projektit	Koha e zbatimit	Donatori	Fondi	Zbatohet në
“Edukimi ligjor dhe Mbrojtja e të Drejtave. Akses i personave të trafikuar dhe grupeve në nevojë”	30 Prill 2007-30 Prill 2008 - Gusht 2008 - Dhjetor 2009	OSBE/ODIHR.	40 131 Eur	Tiranë, Vlorë, Fier

Projekti përbushë edukimin ligjor dhe mbrojtjen e të Drejtave të qytetarëve, duke rritur aksesin e tyre në drejtësi.

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E PERFORMANCES	
Objektivi 1: Edukimi ligjor për rritjen e njohurive për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe personave në rrisht trafikimi mbi të drejtat e tyre ligjore dhe ofrimi i asistencës ligjore falas.	
Treguesit të arritjes	• 71 anëtarë të komunitetit rom në Tiranë, Fier dhe Vlorë janë informuar mbi të drejtat e tyre ligjore në tre çorkshope të organizuara nga Qendra për Nisma Ligjore

	Qytetare në bashkëpunim me organizatën rome “Gruaja Rome e së nesërme”. • 16 viktime të trafikimit të qenieve njerëzore, të akomoduar pranë Qendrës “Të ndryshëm të Barabartë” dhe 16 gra të trafikuar dhe 26 gra të dhunuara në marrëdhëniet familjare të akomoduar pranë “Tjetër Vizion” Elbasan janë informuar mbi të drejtat e tyre ligjore dhe mënyrën se si të ushtrojnë këto të drejta. • 182 gra dhe vajza të komunitetit të zonave rurale të Gramshit dhe Librazhdit janë informuar mbi të drejtat e tyre ligjore. • 11 nxënës të Shkollës Teknologjike në Tiranë janë informuar mbi statusin ligjor të jetimit dhe zbatimin e legjislacionit në lidhje me këtë çështje. • Asistencë ligjore falas për viktime të trafikimit të qenieve njerëzore, e cila përfshin përgatitjen e akteve, këshillimin ligjor dhe përfaqësimin e tyre në gjykatë. • Eshtë ofruar asistencë ligjore falas për 136 raste grash dhe 308 këshillime ligjore për gra dhe vajza në rrezik trafikimi për shkak të vulnerabilitetit të tyre nga varfëria, dhuna në familje dhe papunësia.
Objektivi 2: Zbatimi i legjislacionit anti trafikim dhe lobim për ndryshime në ligj dhe praktikën e zbatimit të tij.	
Tregues të arritjeve	• Propozime ligjore në ligjin “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, paraqitur pranë Zyrës së Koordinatorës Kombëtare kundër trafikimit të qenieve njerëzore.
Objektivi 3: Forcimi i komunitetit Rom përmes forcimit të kapaciteteve të pushtetit lokal dhe qendror dhe organizatave Rome dhe jo rome që kontribuojnë në lidhje me këtë çështje.	
Treguesit e arritjes	QNL ka organizuar një Tryezë të Rrumbullakët me të ftuar nga komuniteti rom, përfaqësues të pushtetit lokal dhe qendror si edhe Organizata Jofitimprurëse Rome dhe jo Rome.
Objektivi 4: Mbështetja e shoqërisë civile dhe përmirësimi i kapaciteteve afat shkurtër dhe afat gjatë të tyre për forcimin e grupeve vulnerable ndaj trafikimit të qenieve njerëzore.	
Treguesit e arritjes	Janë trajnuar nga ekspertët ligjorë të QNL-së 16 përfaqësues të Organizatave Jofitimprurëse në Vlorë, përfshirë stafin e Qendrës Psiko Sociale “Vatra”, Vlorë; 16 përfaqësues të Organizatave Jofitimprurëse Shkodër, përfshirë stafin e Qendrës “Gruaja për

	Gruan”; është forcuar bashkëpunimi me Shërbimin Social Shtetëror, “Tjetër Vizion” Elbasan etj.
Objektivi 5: Ti bëjmë profesionistët e sistemit të drejtësisë gjyqtarët, prokurorët, avokatët, psikologët dhe punonjësit socialë më të ndjeshëm ndaj viktimave të dhunës me bazë gjinore, të rritet niveli i njohurive të profesionistëve mbi standardet ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e viktimave.	
Treguesit arritjes	e Janë organizuar dy trajnime me gjyqtarë dhe prokurorë në 3 Tetor 2008 dhe 5 Dhjetor 2008. Numri i pjesëmarrësve në këto trajnime ishte 49 në total. Në trajnime janë përdorur edhe gjetjet e raportit të përgatitur nga ekspertët e QNL-së “Zhvillimi dhe zbatim i legjislacionit shqiptar, një mjet në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.
Objektivi 6: Të masim sa efektiv është legjislacioni penal dhe civil në parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi i qenieve njerëzore.	
Treguesit arritjes	e U përgatit raporti monitories “Zhvillimi dhe zbatimi i legjislacionit shqiptar, një mjet në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Ky raport përfshin një analizë të legjislacionit dhe monitoron zbatimin e tij nga Gjykata e Krimeve të Rënda dhe Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shkodër, Vlorë e Korçë, në lidhje me veprat penale të trafikimit, si dhe veprat e tjera që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore.
Objektivi 7: Shkëmbimi i eksperiencave me Organizatat që punojnë për adresimin e çështjes së trafikimit të qenieve njerëzore.	
	U organizua më 30 Shtator 2008 një takim për shkëmbimin e eksperiencave midis stafit të QNL-së dhe ofruesëve të shërbimeve për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore ose personat në rrisht trafikimi në Mbretërinë e Bashkuar.

III.

Emri i projektit	Koha e zbatimit	Donatori	Fondi	Zbatohet në
“Rritja e aksesit në drejtësi për gratë dhe vajzat përmes ndihmës ligjore falas” .	Nëntor 2007-Maj 2008	Zbatimi i këtij projekti është mbështetur nga World Learning /FORECAST.		Tiranë

Projekti përmbushi rritjen e aksesit të grave dhe vajzave në sistemin e drejtësisë përmes vazhdimësisë së mbështetjes psikosociale dhe shërbimeve ligjore, rritjes së nivelit të informacionit të komunitetit mbi të drejtat ligjore përmes edukimit ligjor dhe përdorimit të medias së shkruar dhe elektronike.

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E PERFORMANCES	
Objektivi 1: Krijimi i skuadrës pro bono me anëtarë studentë të Fakultetit të Drejtësisë, pranë UFO University, trajnimi dhe përfshirja e anëtarëve të skuadrës pro bono në ofrimin e ndihmës ligjore falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore.	
Treguesit të arritjes	-Eshtë krijuar dhe trajnuar skuadra pro bono pranë UFO University, me 27 anëtarë, studentë të Fakultetit të Drejtësisë, pranë UFO University. -Eshtë përgatitur manuali “Parandalimi i dhunës në familje përmes skuadrave pro bono të studentëve të Fakultetit të Drejtësisë”. -Studentët kanë ofruar gjatë periudhës së zbatimit të projektit 48 këshillime ligjore dhe sociale. Nga këto janë ofruar 140 këshillime ligjore ballë për ballë në ambientet e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare; 200 këshillime ligjore përmes telefonit dhe rreth 140 këshillime ligjore në ëorkshopen me komunitetin. Studentët anëtarë të skuadrës pro bono kanë përgatitur 50 akte nën mbikqyrjen e avokateve të qendrës.

Objektivi 2: Të monitorohet efektiviteti i zbatimit të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”	
Tregues të arritjeve	-U krye monitorimi i zbatimit të ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. -Bazuar në gjetjet e monitorimit u përgatit raporti: “Mjetet ligjore që ofron ligji ‘Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’ dhe ndikimi i tij në luftën kundër këtij fenomeni.” Monitorimi u krye përmes monitorimit të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Vlorë për lëshimin e urdhërave mbrojtës, për periudhën 1.07.2007-30.04.2008. Raporti u përgatit nga studentët e skuadrës pro bono të Fakultetit të Drejtësisë, UFO University nën mbikqyrjen e ekspertëve të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare.
Objektivi 3: Të rritet niveli i informimit të komunitetit, veçanërisht komunitetit në zonat rurale mbi të drejtat dhe mjetet ligjore.	
Treguesit e arritjes	-Kanë përfituar nga workshopet e organizuara nga QNL 365 persona.
Objektivi 4: Të rrisim rolin e medias së shkruar dhe elektronike për informimin e komunitetit mbi të drejtat ligjore dhe shërbimet e ofruara nga QNL dhe organizata të tjera.	
Treguesit e arritjes	-Katër studentë, anëtarë të skuadrës probono kanë përgatitur dhe botuar artikuj në median e shkruar. -Eshtë përgatitur spoti publicitar me pjesëmarrjen e anëtarëve të skuadrës pro bono, me fokus rritjen e ndërgjegjësimit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje. -Studentë të skuadrës <i>pro bono</i> kanë ndarë eksperiencën e tyre në median televizive.

IV.

Emri i projektit	Koha e zbatimit	Donatori	Fondi	Zbatohet në
“Rritja e aksesit të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në sistemin e drejtësisë për të ushtruar të drejtën për kompensim përmes forcimit të kapaciteteve të profesionistëve të sistemit të drejtësisë dhe ndryshimeve ligjore”.	Gusht 2008- Gusht 2009.	Ky projekt është mbështetur nga Ambasada Amerikane në Tiranë.	18743 USD	Tiranë, Fier, Elbasan dhe Korçë.

Projekti përmbushi rritjen e aksesit e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore përmes rritjes së ndjeshmërisë dhe përgjegjësisë së profesionistëve në lidhje me të drejtat e viktimave për kompensim, forcimit të bashkëpunimit të profesionistëve të sistemit të drejtësisë dhe përgatitjes së propozimeve për ndryshime ligjore.

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E PERFORMANCES	
Objektivi 1: Të rritet ndjeshmëria dhe përgjegjësia e profesionistëve, në mënyrë të veçantë avokatëve në lidhje me të drejtat e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në mënyrë të veçantë të drejtës së viktimave për kompensim dhe forcimit të bashkëpunimit të profesionistëve të sistemit të drejtësisë.	
Treguesit të arritjes	- Janë zhvilluar në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë tre trajnime me avokatë në Elbasan, Fier dhe Pogradec; - Janë trajnuar 45 avokatë në lidhje me të drejtat e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në mënyrë të veçantë me të drejtën për kompensim të viktimave. - Eshtë zhvilluar një Tryezë e Rrumbullakët, në të cilin numri i përfituesëve, profesionistë ishte 33. - Eshtë përgatitur një raport mbi nevojën e ndryshimeve ligjore. - Si rezultat i aktiviteteve të kryera në kuadrin e këtij projekti janë forcuar kapacitetet e avokatëve të trajnuar në lidhje me përdorimin e standarteve ndërkombëtare si një mjet për të bërë realitet të drejtat e viktimave të trafikimit të qenieve

	njerëzore; janë forcuar njohuritë e profesionistëve të trajnuar mbi praktikat më të mira në rajon në lidhje me të drejtat e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në mënyrë të veçantë të drejtës për kompensim;
Objektivi 2: Të rritet ndjeshmëria e profesionistëve dhe publikut të gjerë në lidhje me të drejtat e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.	
Treguesit e arritjes	Janë botuar disa artikuj në media me fokus në të drejtat e viktimave të trafikimit si vijon: 1."Leksione për Shqipërinë nga një analizë e krahasuar mbi të drejtën për kompensim të viktimave të trafikimit", shkruar nga Prof.Dr. Aurela Anastasi; 2. "Çështje të praktikës gjyqësore në gjykimet e veprave të trafikimit të qenieve njerëzore. (Të dhëna nga monitorimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Krimeve të Rënda për periudhën 2004-2006) shkruar nga Av.Besa Saraci. 3."Disa probleme të evidentuara në lidhje me ushtrimin e të drejtave nga komuniteti Rom dhe ndërgjegjësimi i tij për zgjidhjen e tyre", shkruar nga Av.Aurela Bozo.
Objektivi 3: Të forcohen kapacitetet e Organizatave Jofitimprurëse që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut në mënyrë të veçantë në parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi i qenieve njerëzore.	
Treguesit e arritjes	Në trajnimet e organizuara në kuadrin e këtij projekti kanë marrë pjesë avokatë dhe përfaqësues të Organizatave Jofitimprurëse si Refleksione, Shkoder; Forumi i Grave në Elbasan; "Të ndryshëm dhe të Barabartë", Qendra Psiko Sociale "Vatra", Vlore; Klinika Ligjore për të Miturit, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut në Demokraci, TLAS, etj. Përmes trajnimeve dhe tryezave të Rrumbullakëta të organizuara janë rritur njohuritë e tyre mbi standartet ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, legjislacionin shqiptar, problematikat e zbatimit të tij si edhe janë fituar shprehje mbi përgatitjen e padisë civile në procesin penal dhe mjete të tjera ligjore për të bërë realitet të drejtat e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.

V.

Emri i projektit	Koha e zbatimit	Donatori	Fondi	Zbatohet në
Forcimi i grave në nevojë përmes ofrimit në vazhdimësi të shërbimeve ligjore dhe psikosociale”.	Prill 2008-Janar 2009	Ky projekt është mbështetur nga Global Fund of Women.	6990 USD	Prill 2008-Janar 2009

Projekti përmbushi rritjen e aksesit të grave dhe vajzave, në mënyrë të veçantë grave dhe vajzave të dhunuara në sistemin e drejtësisë përmes asistencës ligjore dhe mbështetjes psiko sociale falas, rritjes së informacionit mbi të drejtat ligjore dhe përdorimit të medias si një mjet për rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit për tolerancë 0 ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare.

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E PERFORMANCES	
Objektivi 1: Të rrisë aksesin e grave dhe vajzave të dhunuara në sistemin e drejtësisë.	
Treguesit të arritjes	- Janë kryer 500 këshillime ligjore - Janë kryer 500 sesione të mbështetjes psiko sociale - Janë përgatitur 100 akte për në organet e gjyqësorit dhe të tjera.
Objektivi 2: Të rritet ndërgjegjësimi i komunitetit mbi mjetet ligjore që ofron legjislacioni dhe të aftësohet ai për të përdorur të drejtat.	
Tregues të arritjeve	Kanë përfituar në mënyrë të drejtpërdrejtë 250 përfaqësues të komunitetit në zonat rurale të Vaqarrit; Fushe Krujes; Kasharit, Saukut and Prezes.
Objektivi 3: Të përdoren botimet si një mjet për rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit për të adresuar dhunën me bazë gjinore.	
Treguesit e arritjes	Botimet e qendrës dhe website i saj www.qag-al.org janë përdorur për këtë qëllim.

VI.

Emri i projektit	Koha e zbatimit	Donatori	Fondi	Zbatohet në
“Rritja e aksesit dhe besimit të qytetarëve në organet e drejtësisë përmes zbatimit efektiv të legjislacionit shqiptar si një mjet i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit.”	Dhjetor 2006 – Korrik, 2007	Casals & Associates	23 992 EUR	Tirana, Shkodra dhe Vlora

Projekti përmbushi rritjen e efektivitetit të sistemit të drejtësisë dhe institucioneve të administratës publike në luftën kundër praktikave të paligjshme korruptive përmes rritjes së nivelit të ndërgjegjësimit dhe përgjegjësisë së gjyqtarëve, prokurorëve, administratës publike dhe komunitetit me qëllim parandalimin dhe goditjen e praktikave korruptive.

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E PERFORMANCES	
Objektivi 1: Të rritet ndjeshmëria dhe përgjegjësia e strukturave përkatëse shtetërore, gjykatave, prokurorisë dhe organeve të administratës publike në fazat e hetimit, gjykimit dhe ndjekjes penale të veprave kundër autoritetit të shtetit, të kryera nga zyrtarë shtetërorë ose në shërbimet publike, dhe veprave të tjera të lidhura me korrupsionin në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë.	
Treguesit të arritjes	Mjet shumë i rëndësishëm në lidhje me rritjen e ndjeshmërisë së strukturave dhe organeve përkatëse mbi parandalimin dhe ndëshkimin e veprave korruptive ishte monitorim i veprimtarisë së këtyre organeve. U përgatitën nga ekspertët ligjorë skedulat për kryerjen e monitorimit, një skedulë për monitorimin e gjykatës dhe një skedulë për monitorimin e prokurorisë, të cilat luajtën një rol shumë të rëndësishëm në identifikimin e çështjeve, fakteve dhe problemeve. Nëpërmjet këtyre skedulave u mbledhën të dhëna mbi llojin e veprave korruptive të kryera, të dhëna mbi personin e denoncuar dhe të gjykuar, në lidhje me moshën, gjininë, arsimin, profesionin, punësimin, të dhëna nëse vepra korruptive është kryer në bashkëpunim ose jo, të dhëna mbi kohëzgjatjen e procesit të hetimit dhe gjykimit, shkaqeve të pushimit të çështjeve, sanksioneve, masës së dënimit të kërkuar nga prokurori dhe të vendosur nga gjykata, të dhëna mbi referimin në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti

	shqiptar në lidhje me korrupsionin, të dhëna nëse është paraqitur padia civile në procesin penal gjatë gjykimit të çështjeve, të dhëna mbi dënimet alternative të dhëna nga gjykata, etj. Gjetjet e monitorimit u bënë publike përmes botimit të studimit “Organet e drejtësisë në luftë kundër korrupsionit” i cili kontribuoi në kualifikimin e mëtijshëm të profesionistëve të sistemit të drejtësisë”. Ky botim identifikoi çështje të ndryshme në kuadrin e aktivitetit të organeve të gjyqësorit dhe vuri në dukje konkluzione të rëndësishme si edhe rekomandoi përmirësime në sistemin ligjor dhe praktikat e gjyqësorit. Studimi u shërbeu së pari profesionistëve të sistemit të drejtësisë, gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve në mënyrë të veçantë. U evidentuan jo vetëm problemet e veprimtarisë së organeve të drejtësisë, por edhe të zbatimit të një procesi gjyqësor të drejtë e të ndershëm, me qëllim respektimin e mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore gjatë këtij procesi.
Objektivi 2: Rritja e nivelit të informacionit dhe rolit aktiv të qytetarëve në lidhje me mundësitë për tu përfshirë në denoncimin, parandalimin dhe ndjekje penale të veprave korruptive.	
Treguesit e arritjes	Studimi “Organet e drejtësisë në luftë kundër korrupsionit” dhe publikimi i gjetjeve të tij në median e shkruar dhe elektronike ka kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit në denoncimin e akteve korruptive. Studimi evidentoi praktikën e ndjekura nga Prokuroria dhe Gjykata për të gjykuar dhe goditur veprat penale që lidhen me korrupsionin, duke i bërë ato të njohura për publikun. Ky studim ka ndihmuar në informimin e shtetasve dhe rritjen e besimit të tyre në organet përkatëse. U përgatitën dhe u transmetuan emisione në televizionet e Shkodrës, Vlorës dhe Tiranës, të cilat kontribuan në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut mbi parandalimin dhe ndëshkimin e veprave korruptive me mjete ligjore. Për rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit ndihmoi edhe dramatizimi i një gjyqi imitues në lidhje me korrupsionin, realizuar nga studentë të Fakultetit të Drejtësisë së Universitetit të Shkodrës.

	U botuan disa artikuj në median e shkruar si vijon: 1. “Kodi Penal dhe korrupsioni”, botuar në gazetën “Shqip” në 28 Korrik 2007, përgatitur nga Jola Xhafo. 2. “Korrupsioni, si ta luftojmë atë?”, botuar në “Gazeta Shqiptare”, në 3 Gusht 2007, përgatitur nga Vasilika Hysi 3. “Drejtësia dhe lufta ndaj korrupsionit”, botuar në gazetën “Panorama”, në 6 Gusht 2007, përgatitur nga Prof.Dr. Aurela Anastasi. 4. “Roli i Kodit Penal në luftën ndaj korrupsionit”, botuar në gazetën “Republika”, në 3 Gusht 2007.
Objektivi 4: Të analizohet legjislacioni ekzistues për ndëshkimin e veprave që lidhen me korrupsionin dhe identifikimin e çështjeve të ngritura nga problemet e identifikuar gjatë zbatimit të legjislacionit në praktikë, dhe krahasimit me standartet e parashikuara në aktet ndërkombëtare dhe me praktikat e vendeve të përparuara, në luftën kundër korrupsionit.	
Treguesit e arritjes	Studimi përfshin analizën e legjislacionit ekzistues për ndëshkimin e veprave që lidhen me korrupsionin, krahasimin e tij me standartet e parashikuara nga aktet ndërkombëtare dhe përvojën e vendeve të tjera të përparuara në luftën kundër korrupsionit duke kontribuar kështu në përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit dhe përafrimin e tij me atë ndërkombëtar.
Objektivi 5: Studimi i çështjeve nga perspektiva gjinore, konkluzione, përgjithësime dhe rekomandime.	
Treguesit e arritjes:	Një pyetsor nga perspektiva gjinore u përgatit nga një sociolog. Ky pyetësor u përdor nga ekspertët monitories, të cilët e plotësuan me të dhëna nga vendimet e formës së prerë të gjykatave objekt monitorimi. Përmes këtij pyetsori u mbledhën të dhëna mbi gjininë e personit të denoncuar, gjininë e prokurorit të çështjes, gjininë e gjyqtarit të çështjes, të dhëna në lidhje me kualifikimin ligjor të aktit korruptiv dhe sanksionit, në lidhje me gjininë, lidhjen midis gjinisë dhe llojit të akteve korruptive të kryera, lidhjen midis gjinisë dhe sanksioneve të dhëna nga gjykata, etj. Përmes këtyre pyetsorëve u mbledhën të dhëna mbi lidhjen

	midis gjinisë dhe çështjeve të pushuara. Nëpërmjet skedulës për monitorimin e administratës publike u grumbulluan të dhëna mbi aktet disiplinore administrative të dhëna, në përgjithësi si edhe sipas gjinisë.
Objektivi 6: Studimi i transparencës në organet e administratës publike në lidhje me korrupsionin dhe luftën ndaj tij.	
Treguesit e arritjes:	Studimi u ofroi ndihmë modeste të gjitha strukturave shtetërore që hartojnë dhe zbatojnë politikën në luftën kundër korrupsionit, që kryejnë reformat ligjore dhe japin ekspertizë të ndryshme në këtë fushë. Juristët dhe punonjësit e tjerë të sistemit të institucioneve publike u kualifikuan më tej dhe u ndërgjegjësuam përmes këtij studimi.
Objektivi 7: Përgatitja dhe ndërgjegjësimi i profesionistëve të ardhshëm të sistemit të drejtësisë.	
Treguesit e arritjes:	Gjatë zbatimit të projektit, QNL bashkëpunoi me studentët e Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës dhe Universitetit të Shkodrës. Puna, praktika dhe ndjeshmëria e monitorimit u përcollën tek studentët e drejtësisë. U krijua dhe u trajnuan skuadra monitoruese, e cila kreu me sukses detyra të monitorimit të praktikave të prokurorisë dhe Gjykatës në Tiranë, e Vlorë. U krye dramatizimi i gjyqit imitues nga studentët e Fakultetit të Drejtësisë, Shkodër. U përgatitën 12 ese nga studentët dhe eseja më e mirë u përzgjedh eseja e përgatitur nga studenti i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës Alban Alimema, me titull “Korrupsioni në Shqipëri: Shkaqet, pasojat dhe lufta ndaj tij nëpërmjet zbatimit të legjislacionit”. Kjo ese u përfshi në botimin “Organet e drejtësisë në luftën kundër korrupsionit”

VII.

Emri i projektit	Koha e zbatimit	Donatori	Fondi	Zbatohet në
“Rritja e nivelit të njohurive të komunitetit dhe vecanërisht grave dhe vajzave, në zonat rurale dhe ndërrurbane mbi të drejtat e grave dhe aftësimi i tyre për të përdorur këto të drejta”.	2007-2008	USA Embasy	16 255 USD	Fushë Krujë, Sauk, Kashar, Babrru, Bathore

Projekti përmbushi rritjen e aksesit të grave dhe vajzave në zonat rurale në sistemin e drejtësisë përmes aktiviteteve që kanë kontribuar në rritjen e nivelit të njohurive të tyre mbi të drejtat e tyre ligjore si edhe forcimin e aftësive të tyre për ti përdorur këto të drejta.

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E PERFORMANCES	
Objektivi 1: Të rritet niveli i njohurive të grave dhe vajzave në zonat rurale mbi të drejtat e tyre ligjore si edhe të forcohen aftësitë e tyre për ti përdorur këto të drejta.	
Treguesit të arritjes	• Janë organizuar dhjetë workshope me komunitetin në zonat Fushë Krujë, Sauk, Kashar, Babrru dhe Bathore. • Spoti televiziv dhe emisionet televizive, materialet informuese të cilat ju janë shpërndarë anëtarëve të target grupit ishin mjete të tjera të përdorura nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare për të bërë komunitetin e grave dhe vajzave në zonat rurale më të ndërgjegjshëm dhe të aftë të përdori mjetet ligjore.
Objektivi 2: Të forcohen kapacitetet e pushtetit lokal dhe Organizatave Jofitimprurëse në adresimin e dhunës në familje përmes përdorimit të mjeteve ligjore që ofron ligji nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.	
Tregues të arritjeve	• Në 10 workshopet e organizuara në Fushë Krujë, Sauk, Kashar, Barru dhe Bathore kanë marrë pjesë përfaqësues të pushtetit lokal dhe Organizatave Jofitimprurëse që punojnë në këto zona. • Eshtë organizuar Tryeza e Rrumbullakët me temë “Ligji ‘Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’ dhe roli i administratorit social në zbatimin e tij”.Ky aktivitet u zhvillua me mbështetjen e Departamentit të Shërbimeve Sociale në Bashkinë e Tiranës. Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin edhe përfaqësues të Bashkisë Fushë Krujë dhe komunës së Kasharit. Pjesëmarrësit u trajnuan mbi ligjin, mësuan si të përgatisin një kërkesë për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrit të mbrojtjes për të miturit, si subjekt i legjitimuar për paraqitjen e këtyre kërkesave nga ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare.” Në këtë tryezë morën pjesë edhe përfaqësues nga Ministria

	e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta si edhe përfaqësues të Organizatave Jofitimprurëse si: Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza të dhunuara; Strehëza për Gra dhe Vajza të dhunuara, Shoqata Në dobi të gruas, Qendra për Zhvillimin e Grave Rurale dhe Qendra “Ekspertët”
--	---

VIII.

Emri i projektit	Koha e zbatimit	Donatori	Fondi	Zbatohet në
“Parandalimi i dhunës në familje përmes skuadrave studentore pro bono dhe klinikës së ligjit.”	Dhjetor 06-Prill 2007	Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, SOROS	6993 USD	Tiranë dhe Vlorë

Projekti përmbushi rritjen e aksesit të grave dhe vajzave të dhunuara përmes asistencës ligjore falas ofruar nga avokatet e QNL-së dhe anëtarët e skuadrave probono, studentë të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti Vlorë.

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E PERFORMANCES	
Objektivi 1: Gratë dhe vajzat të njohin të drejtat ligjore të parashikuara në ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, dhe legjislacionin në mbrojtje nga dhuna në familje si edhe të përdorin këto të drejta.	
Treguesit të arritjes	- Gjatë zbatimit të projektit “Parandalimi i dhunës në familje përmes skuadrave studentore pro bono dhe klinikës së ligjit”, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, nëpërmjet avokates, gjithashtu përgjegjëse për koordinimin e projektit, në krye të skuadrës pro bono, ka bërë të mundur informimin e grave dhe vajzave të dhunuara të referuara në Qendrën tonë mbi Ligjin “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, për mjetet ligjore që parashikohen në ligj, për autoritetet përgjegjëse dhe detyrat e përgjegjësitë konkrete të këtyre autoriteteve. - Ky informim për të drejtat ligjore të parashikuara në këtë ligj është realizuar edhe nëpërmjet pjesëmarrjes së avokatëve të Qendrës për Nisma

	Ligjore Qytetare në emisionin televiziv, pranë Televizionit Shqiptar, “Jo vetëm kafe”, në datën 29 Nëntor 2007, në 16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore. Në emisionin televiziv të datës 10 janar 2008, “Jo vetëm kafe”, në Televizionin Publik Shqiptar morën pjesë avokatja mbikqyrëse dhe studentë të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit Tiranë, anëtarë të skuadrës pro bono, Dritan Palnikaj dhe Lindita Troka.
--	---

Objektivi 2: Rritja e aksesit të grave dhe vajzave të dhunuara në sistemin e drejtësisë, përmes këshillimeve ligjore individuale dhe përgatitjes së akteve.

Tregues të arritjeve	Janë ofruar këshillime dhe janë përgatitur akte gjatë zbatimit të këtij projekti për një numër rastesh të grave dhe vajzave të dhunuara. Numri mesatar i grave dhe vajzave të dhunuara të paraqitura pranë qendrës sonë për të përfutur nga shërbimet është 4 në ditë. Këto këshillime ligjore janë kryer nëpërmjet këtyre mënyrave: së pari janë realizuar këshillime ligjore ballë për ballë për kliente të ndryshme paraqitur në qendër. Së dyti: janë kryer këshillime ligjore nëpërmjet telefonit si për kliente të vjetra të qendrës, pra të mbartura nga periudha e mëparshme ashtu edhe për kliente të reja të cilat kanë telefonuar në numrin e telefonit të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare për këshillim ligjor. Së treti: këto këshillime janë mundësuar edhe në aktivitetet e ndryshme edukuese apo ndërgjegjësuere në të cilat avokatët e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare kanë marrë pjesë si lektorë.
----------------------	--

Objektivi 3: Aftësimi i studentëve të Fakultetit të Drejtësisë dhe zbatimi i njohurive të tyre nëpërmjet mbështetjes ligjore falas për këtë target grup.

Treguesit e arritjes	Aftësimi i studentëve të Fakultetit të Drejtësisë është kryer nëpërmjet trajnimit vazhdues të skuadrës pro bono, me temë ‘Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe roli i skuadrës pro bono në zbatimin e tij.’ Ky seminar trajnues u organizua në Tiranë, në datën 20.12.2007. Numri i pjesëmarrësve në këtë seminar ishte 20. Për një cilësi sa më të mirë të seminarit trajnues u përgatit një manual profesional në përbërje të cilit u përfshinë disa tema, ndër të cilat :
----------------------	--

	1. Koordinimi i përpjekjeve-sfidë për të gjithë aktorët që adresojnë dhunën gjinore në marrëdhëniet familjare; 2. Parandalimi i dhunës në familje-faktor i domosdoshëm për arritjen e barazisë gjinore; 3. Mbrojtja ligjore falas; 4. Evolucion i përgjigjeve të sistemit të drejtësisë ndaj dhunës në familje në shtetin e Neë Yorkut; 5. Çështjet gjyqësore lidhur me kujdestarinë dhe të drejtën e vizitës së fëmijëve, në rastet e dhunës në familje; 6. Kërkesë-Padi për lëshimin e Urdhërit të Mbrojtjes; 7. Kërkesë -Padi për lëshimin e Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes; 8. Guida e intervistimit, Si të drejtojmë një intervistë; 9. Kazuse të ndryshme;
Objektivi 4: Forcimi i lëndës së Klinikës së ligjit në Fakultetin e Drejtësisë, UT.	
Treguesit e arritjeve:	Ky objektivi është përmbushur nëpërmjet bashkëpunimit me Departamentin e të Drejtës Penale, të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti Tiranë. Gjithashtu janë krijuar e forcuar marrëdhëniet e bashkëpunimit me Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti Vlorë.
Objektivi 5: Ndërgjegjësimi i komunitetit për një tolerancë 0 ndaj dhunës së ushtruar në familje ndaj grave dhe vajzave.	
Treguesit e arritjeve:	• Ndërgjegjësimi i komunitetit është kryer nëpërmjet lancimit të aktivitetit në emisione të ndryshme në Televizionin Shqiptar. • Kjo është bërë e mundur edhe nëpërmjet botimit të shkrimit Parandalimi i dhunës në familje-faktor i domosdoshëm për arritjen e barazisë gjinore”, shkruar nga Prof.Dr. Aurela Anastasi, në Suplementin “Sfidat Gjinore”, gjatë muajit Dhjetor 2007. • studentët e skuadrës probono janë përfshirë në procesin e përdorimit të medias së shkruar si një mjet për tolerancë 0 ndaj këtij fenomeni. Kështu studentja e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti Tiranë, Jonida Lamaj ka përgatitur shkrimin “Jo vetëm fenomen por edhe fakt”, i cili është botuar në gazetën “Republika”, në datën 20 shkurt 2008. Studentja Klesta Hysi, studente e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti Tiranë, ka përgatitur shkrimin “Pro bonos kundër dhunës në familje, botuar në gazetën “Republika”, në 2 Mars 2008.

VI. ANEX 2- PROJEKTE ZBATUAR NGA QNL NË BASHKËPUNIM ME OJF TE TJERA.

I.

Emri i projektit	Koha e zbatimit	Donatori	Fondi	Zbatohet në
« Transparenca-nje rruge drejt besimit te publikut » Projekti i zbatua nga Qendra Aleanca Gjinore per Zhvillim, Skuadra 2000 dhe Qendra per nisma ligjore dhe qytetare	1 vit	Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë Soros	4200 USD Qendr a per nisma ligjore qytetare	Tiranë, Shkodër, Pogradec, Korçë, Elbasan, Berat, Fier, Vlorë dhe Durrës.

Projekti synonte të siguronte njohuri të qarta lidhur me konceptin “transparenca në sektorin jofitimprurës” dhe mënyrat e arritjes së transparencës me publikun. Një qëllim tjetër i projektit ishte vendosja e bashkëpunimit midis OJF-ve të ndryshme si dhe të mundësonte ndarjen e experiencës së grumbulluar në zhvillimin e komunitetit si dhe në fusha të tjera të aktivitetit të tyre

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E PERFORMANCES	
Objektivi 1: Të sigurohen njohuri të qarta lidhur me konceptin “transparenca në sektorin jofitimprurës” dhe mënyrat e arritjes së transparencës me publikun.	
Treguesit të arritjes	- QNL ofroi ekspertizë për përgatitjen e modulit të trajnimit me titull “Transparenca- një rrugë drejt besimit të publikut ”. - QNL ofroi ekspertizë për përgatitjen e nje pyetësori i cili u shpërnda gjatë trajnimeve që u zhvilluan me përfaqësues të organizatave jofitimprurëse. Pyetësori mblodhi informacion lidhur me mënyrën se si e konceptojnë transparencën vetë përfaqësuesit e organizatave, si e konsiderojnë besimin që ka publiku ndaj tyre, cili është niveli i transparencës së tyre edhe mënyrat dhe strategjitë që përdorin për ta arritur atë, si edhe mënyrat dhe format që sugjerojnë për rritjen e transparencës. - U trajnuan 12 trajnerë për çështje të transparencës.

	• U organizuan 14 trajnime me përfaqësues të organizatave Jofitimprurëse.
Objektivi 2: Forcimi i bashkëpunimit midis OJF-ve të ndryshme si dhe mundësimi i shkëmbimit të experiencës së grumbulluar në zhvillimin e komunitetit si dhe në fusha të tjera të aktivitetit të tyre.	
Tregues të arritjeve	• U publikua dhe u shpërnda broshura "Transparenca – një rrugë drejt besimit të publikut" • Përmes shkëmbimit të eksperiencës mes Organizatave Jofitimprurëse u forcua bashkëpunimi midis tyre dhe u përfitua nga eksperiencat e mira. • U organizuan 14 trajnime me përfaqësues të organizatave Jofitimprurëse në Tiranë dhe në rrethe.

II.

Emri i projektit:	Koha e zbatimit	Donatori	Fondi	Zbatohet në
"Të bëjmë realitet zbatimin e ligjit kundër dhunës në familje në Shqipëri" Ky projekt u zbatua nga Rrjeti kundër Dhunës Gjinore dhe Trafikimit	2 vjet, 2008-2009	UNITED NATIONS TRUST FUND	36 709 USD	Rrëshen, Shkodër, Vlorë, Berat, Pogradec.

Projekti adresoi nevojën për të luftuar dhunën në familje në Shqipëri duke krijuar mekanizma monitorues dhe shërbime referimi efektive, ndërsektoriale dhe të qëndrueshme në nivel lokal që do të siguronin zbatimin efektiv të Ligjit "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", akteve nënligjore si edhe strategjive mbështetëse. Ky projekt u zbatua nga Rrjeti kundër Dhunës Gjinore dhe Trafikimit, anëtarë të të cilit janë Shoqata Refleksione, Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim dhe Strehëza për Gra dhe Vajza të Dhunuara.

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E PERFORMANCES

Objektivi 1: Krijimi i një modeli referimi funksional në nivel lokal përmes Këshillave kundër dhunës në familje për të siguruar një sistem referimi shumë sektorial i cili adreson dhunën kundër grave në mënyrë efektive.

Treguesit të arritjes

U krijuan Këshillat në pesë rrethet që u mbuluan nga projekti. Në këto këshilla morën pjesë përfaqësues të aktorëve kyç në nivel lokal të cilët ngarkohen me përgjegjësi në adresimin e dhunës në marrëdhëniet familjare nga ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Në këshillat kundër dhunës në familje morën pjesë përfaqësues të shërbimeve sociale pranë qeverisjes lokale; oficerë të policisë nga njësia e specializuar kundër dhunës në familje; ofrues të kujdesit shëndetësor si mjekë, infermierë; gjyqtarë, prokurorë, avokatë, ekspertë të mjeksisë ligjore, përfaqësues të Zyrës së Përmbarrimit, përfaqësues të strehëzave dhe Organizatave Jofitimprurëse që ofrojnë programme rehabilitimi, përfaqësues të organizatave të komunitetit, mësues, prindër dhe përfaqësues të medias. Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare u mbështetën dhe u referuan nga njëri aktor tek aktorët e tjerë.

Objektivi 2: Të promovojë kompetencë për personelin në shërbimet sociale, shëndetësi, polici, drejtësinë penale dhe sistemet edukative si edhe një nivel më të lartë të përgjegjësisë nga aktorë publikë dhe privatë në parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje.

Tregues të arritjeve

U zhvilluan disa ëorkshope dy ditore mbi ligjin “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe strategjinë kombëtare mbi dhunën në familje për stafin e qeverisjes vendore, officerët e policisë, avokatë, përfaqësues të Departamentit të Mjeksisë Ligjore, punonjës të zyrave të Përmbarrimit, punonjës socialë, punonjës të qendrave shëndetësore dhe Organizatat Jofitimprurëse që punojnë për adresimin e dhunës në marrëdhëniet familjare. Organizimi i këtyre ëorkshopeve së pari rriti nivelin e ndërgjegjësimit dhe njohurive mbi rolin dhe përgjegjësitë e autoriteve përgjegjëse të parashikuara në ligjin ‘Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’ si edhe rriti njohuritë dhe kapacitetet e përfaqësuesëve të autoriteteve përgjegjëse në adresimin e dhunës me bazë gjinore.

Objektivi 3: Të rritet ndërgjegjësimi mbi dhunën në familje, të edukohen gratë në lidhje me të drejtat dhe ligjin, dhe të angazhohen anëtarët e komunitetit në mënyrë të veçantë burrat dhe djemtë në fushata kundër saj.

Tregues të arritjeve

Përmes fushatave të ndërgjegjësimit publik, spotit në radio në 16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore, fushatës së fjongove të bardha u rrit ndjeshmëria mbi çështjen e dhunës në familje si edhe u inkurajua një debat publik në lidhje me këtë çështje.

Përmes organizimit të workshopeve me komunitetin u rrit ndërgjegjësimi mbi dhunën në familje dhe mbi faktin se çështja e dhunës në familje nuk duhet të konsiderohet një çështje private por një çështje e gjithë shoqërisë.

Objektivi 4: Të ndërtohen kapacitete organizative në nivel lokal që të monitorojnë dhe analizojnë të dhëna mbi dhunën në familje, duke përfshirë një database monitorues mbi progresin e bërë në zbatim të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Tregues të arritjeve

Përmes angazhimit të ekspertes së Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare u mbledhën të dhëna mbi zbatimin e Ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe strategjisë së dhunës në familje, në Vlorë. Të dhënat reflektuan qartë efektivitetin e sistemit të referimit të krijuar gjatë periudhës së zbatimit të këtij projekti si edhe nevojat për përmirësimin e tij në të ardhmen. Përmes të dhënave dhe raportit të përgatitur në bazë të tyre u identifikuan fushat ku nevojiten përmirësime dhe ndërhyrje. Përmes këtij aktiviteti u zhvilluan mjete advokacie për zbatimin e ligjit ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’ në nivel lokal. Arritja e krijimit të një database mbi progresin e bërë në zbatim të këtij ligji shërbeu edhe si një mundësi për të forcuar bashkëpunimin me qeverisjen qendrore dhe shkëmbimin e eksperiencës në këtë fushë.

III.

Emri i projektit:	Koha e zbatimi	Donatori	Fondi	Zbatohet në
“Shërbim Ligjor Falas në Gërdec”	2008-2009	Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, SOROS	5877.95 USD	Gërdec

Projekti forcoi komunitetin e zonës së Gërdecit përmes ofrimit të mbështetjes ligjore falas.

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E PERFORMANCES	
Objektivi 1: Të mbështesë komunitetin në zonën e Gërdecit përmes ofrimit të asistencës ligjore falas.	
Treguesit të arritjes:	Me qëllim identifikimin e rasteve dhe mbështetjen e tyre janë organizuar në bashkëpunim me TLAS, takime sistematike me komunitetin e zonës së Gërdecit dhe 30 këshillime ligjore. Avokatët e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare kanë përfaqësuar në gjykatë 3 raste individuale me objekt çeljen e dëshmisë së trashëgimisë ligjore. Asistenca ligjore ka konsistuar në: përgatitjen e dokumentacionit; përgatitjen e kërkesës dhe paraqitjen në gjykatë; përfaqësimin e rasteve në gjykatë dhe tërheqjen nga gjykata të vendimeve të formës së prere për rastet e ndjekura në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.
Objektivi 2: Të rritet ndërgjegjësimi dhe roli i kuadrit ligjor dhe zbatimit të tij për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi në punë.	
Tregues të arritjeve	Ekspertet e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, Prof.Dr. Aurela Anastasi, Prof.As.Dr. Arta Mandro dhe Av.Vjollca Mecaj përgatitën një raport mbi kuadrin ligjor dhe efektivitetin e tij për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi në punë. Raporti përfshin konkluzione të rëndësishme dhe rekomandime me qëllim rritjen e efektivitetit të legjislacionit dhe zbatimit të tij në mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi në punë.
Objektivi 3: Të rritet dhe forcohet bashkëpunimi me organizatat Jofitimprurëse që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.	

Tregues të arritjeve	Përmes aktiviteteve të organizuara në kuadrin e zbatimit të këtij projekti është forcuar bashkëpunimi midis Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, TLAS dhe Organizatës “Mjaft”.

IV.

Emri i projektit:	Koha e zbatimit	Donatori	Fondi	Zbatohet në
Të përdorim instrumentin HerRWAI për të bërë realitet të drejtat e qytetarëve në fushën e shëndetit mendor.	Dhjetor 07-Prill 2008	Aim for Human Rights	2000 Euro	Tiranë

Projekti prmbushi rritjen e aksesit të qytetarëve në sistemin shëndetësor duke përdorur instrumentin HerRWAI, përmes monitorimit të zbatimit të legjislacionit dhe politikave ekzistuese në këtë fushë si edhe përmes sygjërimeve të frytshme për përmirësimin e tyre.

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E PERFORMANCES	
Objektivi 1: Të analizohen legjislacioni dhe politikat e shëndetit mendor.	
Treguesit të arritjes	Studimi përfshin: analizën e konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe akteve të brendshme, të cilat fokusohen në fushën e shëndetit dhe në mënyrë të veçantë në fushën e shëndetit mendor; dispozitave në Kodin civil dhe penal relevante me fushën e shëndetit mendor, ligjit mbi shëndetin mendor në Shqipëri dhe sygjërime për përmirësimin e tij; Dokumentit Politik i Shëndetit Mendor në Shqipëri; Planit të Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor në Shqipëri; Deklaratës së Shëndetit Mendor për Europën; Protokollit Opsional të Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Torturës dhe roli i Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit; Strategjisë mbi Shërbimet Shëndetsore dhe impaktit të saj në fushën e shëndetit mendor në Shqipëri; Rregullores së Shërbimeve të Shëndetit Mendor.

	Raporti përfshin analizën e kuadrit ligjor dhe politik si edhe problematikat në zbatimin e tyre.
Objektivi 2: Të forcohet bashkëpunimi midis Organizatave Jofitimprurëse që punojnë në fushën e shëndetit mendor.	
Tregues të arritjeve	Aktivitetet e këtij projekti u organizuan në bashkëpunim me organizatat Fountain House, Shoqatën “Alternativa”, Qendrën Shqiptare për Zhvillimin e Shëndetit Mendor, Qendrës Shqiptare për rehabilitimin e Traumës dhe Torturës etj.
Objektivi 3: Të përdoret raporti si një mjet lobimi për të përmirësuar situatën në fushën e shëndetit mendor.	
Tregues të arritjeve	Raporti u bë i njohur për Organizatat Jofitimprurëse që punojnë në fushën e shëndetit, në mënyrë të veçantë në fushën e shëndetit mendor dhe institucioneve shtetërore përkatëse.

FOTO-GALERI



Foto nga trajnimet me gjyqtarë dhe prokurorë, organizuar nga QNL në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës mbështetur nga OSBE/ODIHR.



Foto nga trajnimet me gjyqtarë dhe prokurorë, organizuar nga QNL në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës mbështetur nga OSBE/ODIHR.



Foto nga trajnimet me gjyqtarë dhe prokurorë, organizuar nga QNL në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës mbështetur nga OSBE/ODIHR



.Foto nga trajnimet me gjyqtarë dhe prokurorë, organizuar nga QNL në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës mbështetur nga OSBE/ODIHR.



Foto nga puna në grupe në trajnimet me gjyqtarë dhe prokurorë, organizuar nga QNL në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës mbështetur nga OSBE/ODIHR.



Avokate Besa Saraci dhe anëtari i skuadrës probono Alban Duraj, në trajnimin e skuadrës probono, Tiranë 2008.



Foto nga aktiviteti i skuadrës *probono*, Anëtares e skuadrës probono Lindita Trokaj dhe Klesta Hysi gjatë një dramatizimi, Tiranë 2007.



Foto nga Tryeza e Rrumbullakët me temë: “Për një zbatim më të mirë të legjislacionit shqiptar, si mjeti më i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit”, Tiranë 2007.



Shkodër, 2007



Tiranë 2007
QNL dhe media elektronike